

● BREAKING NEWS

INTEGRIMI I SHQIPËRISË NË BE, AMBASADORJA YURI KIM DEL ME REAGIMIN E RËNDËSISHËM: T



AKTUALITET

Ekzekutohet ish-anëtari i Bandës së Lushnjes, trupi i 38-vjeçarit gjendet pranë lumit Shkumbin, në maj ishte liruar nga burgu

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
18 TETOR 2021




Një 38-vjeçar është ekzekutuar dhe më pas trupi i tij është hedhur në lumin Shkumbin. Paraditen e djeshme në Peqin u gjet një trup i pajetë i qëlluar me dy plumba, ndërsa më pas rezultoi se bëhej fjalë për Alban Semakun, një person i njohur për drejtësinë shqiptare. 38-vjeçari rezultoi i dënuar me herët për disa vepra penale, pasi ka qenë pjesë e “Bandës së Lushnjes”. Semaku, i cili deri në vitin 2011 mbante emrin Elton Mermali, u gjet i ekzekutuar me armë zjarri, ndërsa trupi ishte hedhur në një zonë ku banorët derdhnin mbeturina. Ai dyshohet të jetë vrarë mbrëmjen e së shtunës. Ka dyshime se Semaku është ekzekutuar diku tjetër dhe se më pas trupi u soll në vendin ku edhe u gjet. “Në vijim të veprimeve hetimore të kryera nga grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për verifikimin e identitetit të shtetasit të vrarë me armë zjarri, i cili është gjetur në afërsi të lumit Shkumbin, në lagjen Çezmë, Peqin, pas verifikimeve të kryera, rezultoi se ishte shtetasi Alban Semaku, 38 vjeç, banues në Lushnjë, i cili deri në vitin 2011 mbante emrin Elton Mermali”, tha policia. Sipas njoftimit për shtyp, në vitin 2006, ky shtetas është ekstraduar nga Italia, pasi Gjykata e Lushnjes, me vendimin e datës 28.08.2003 i ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprën penale “Vrasja”, ndodhur në qytetin e Lushnjes, kryer në kuadër të organizatës kriminale të Lushnjes. Ndërsa më datë 16.03.2015 është arrestuar në flagrancë, pasi në lagjen “Gafurr Muço”, Lushnjë, për motive të dobëta, ka kanosur për jetën, me armë zjarri, shtetasin M. T. Gjatë kontrollit personal të ushtruar ndaj shtetasit Alban Semaku, iu gjetën dhe iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë e tipit “Zastava”, një krehër pistolette me 6 fishekë dhe dy doza heroinë. Me vendimin e datës 16.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë është dënuar me 6 vjet e 8 muaj burg për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake” dhe “Kanosja” dhe është liruar nga burgu më datë 06.05.2021, pasi ka vuajtur dënimin në I.E.V.P Peqin.


Banda e Lushnjes

Banda e Lushnjes, është ndër të parat që kishte një organizim të mirëstrukturuar në formë piramide. Aldo Bare ishte udhëheqësi me autoritet absolut. Fjala e tij nuk diskutohej, por thjesht zbatohej. Ai thirrej “Kryetari”, “I madhi”, “Plaku” dhe “Profesori”. Pranë tij, si njerëz që shpërndanin dhe zbatonin detyrat e “profesorit” ishin Enver Dondollaku, Erjon Cici, Arben Boriçi, Ilir Stërgu, Edjan Xhafa, Maksim Çela dhe Leonard Prifti që ishte vrasësi më i besuar i Bares. Referuar dosjes hetimore, anëtarë të tjerë pjesë e bërthamës kryesore që operonte në Lushnje ishin edhe Afrim Hoxha, Enver Boriçi, Dritan Vila, Petrit Liçi, Erion Kashari, Elton Mermali, Arjan Aliço, Alxhi Nallbani etj. Në 3 gusht të vitit 1997, ekzekutohet në vendin e quajtur kthesa e Blerimit në periferi të Lushnjes shqiptaro maqedonasi Xhevat Demiri, i njohur me nofkën “Kosovari”. Ai konsiderohej njeri i afërt i Artur Dajës. Atë ditë, Demiri së bashku me gruan Mimosën dhe dy fëmijët po ktheheshin nga plazhi drejt qytetit. Sipas dëshmitarëve, Aldo Bare, Ilir Stërgu, Enver Dondollaku i njohur me nofkën “Goni” dhe Afrim Hoxha, i bëjnë shenjë të ndalë fugonin. Demiri zbret dhe pasi shkëmbejnë disa fjalë e ekzekutojnë me kallashnikovë. Objektivi i radhës i Aldo Bares ishte Gramoz Selmani, krahu i djathtë i Artur Dajës. Për lokalizimin e tij, banda kishte marrë peng persona të afërm të tij në të ashtuquajturin Komisariati nr. 2. Në 13 shkurt të vitit 1998, Selmani udhëtonte me një fuoristradë me Masar Aliun dhe Nimet Zenelin. Në vendin e quajtur Kolonjë, ata bien në pritë. Aldo Bare, Arben Boriçi, Ilir Stërgu dhe Enver Dondollaku kanë hapur zjarr njëkohësisht me breshëri. Shoferi Masar Aliu nxjerr mjetin nga rruga dhe bashkë me Nimet Zenelin vrapojnë drejt Kolonjës. Si këto ndodhën dhe shumë vrasje të tjera.


Më të lexuarat




Ish-kryeprokurori i Krimeve të Rënda: Shqipëria nuk mund të përballojë kaq shumë personazhe të botës së krimit, ata kanë mësuar gjuhë të huaj, organet tona jo




“Se vendos ti atë o zotëri! A ka mundësi të kesh etikë?”, Fitim Zekthi përplaslet me Shkëlqim Hajdarin: Mos gënjëni njerëzit...




Publikohen pamje të reja/ Pasi sistemuan trupin e pajetë të Jan Prengës, rrëmbyesit heqin maskat dhe ndërrojnë rrobat



Do të ketë zgjedhje të reja vendore? Përgjigjet Sokol Hazizaj: Opozita me dy koka mund të mos jetë...



Aleksandër Çipa tregon planin e Lulzim Bashës: Po e përdor për të eklipsuar Sali Berishën



Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë propozon shkarkimin e prokurorit të njohur, shkelje të rënda të ligjit!




Analisti i njohur: Gjërat do të shkojnë drejt një pazari mes Ramës dhe Bashës, ja çfarë pritët të ndodhë




Arjan Curri paralajmëron “tërmet” në PD: Me këtë lëvizje Basha do të “fundosë” 15 deputetë demokratë




Padia e PD në SPAK për energjinë, reagon administratori i OSHEE: Padituri ose e qëllimshme



Ekstradohet në Itali “mbreti” shqiptar i kokainës, mediat italiane: Përmblyti vendin me drogë (Emri)



“Janë shumë të fuqishëm në Tiranë”, gazetari i njohur nxjerr prapaskenat e forta: Këta personazhe janë përfshirë në vrasje kriminale në Tiranë dhe Vlorë



Gati 4 mijë testimet! Ja sa raste të reja me COVID u regjistruan në 24 orët e fundit në Shqipëri, zbulohen zonat më të nxehta, 8 humbje jete

Mesazhe Promocionale

Gossip



■ ■ ■ ■ ■ ■ ■ ■
Juristja e njohur shqiptare zbulon lidhjen 8 vjeçare: Më dhuron makina dhe diamant...

Redona Koçi është një nga vajzat më të komentuar...

Opinione

Demokratë, “non grata” amerikane nuk është për...

BESI BEKTESHI

Mos rastësisht kanë harruar dhe “mos lejinin e ...

YLLI MEÇE

O Sali Berisha, na e bëre dhe partinë si çarçaf...

BARDHYL BEJKO

Komunikatë e policisë në seri: Autori në vendng...

LEXO OPINIONE TE TJERA